



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 7, datë 22.06.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10²⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|--------------------|----------------------|
| 1.Jonela Halili | 16.Jerina Dervishaj |
| 2.Sokol Kushta | 17.Evis Allushi |
| 3.Brunilda Saliaj | 18.Liljana Breshani |
| 4.Migena Balla | 19.Ina Islamaj |
| 5.Ramona Jaho | 20.Englantina Imeraj |
| 6.Edison Kapaj | 21.Sulltana Bilbilaj |
| 7.Edlira Kapllanaj | 22.Lindrit Beqiraj |
| 8.Frosina Qyrdeti | 23.Fatos Rukaj |
| 9.Simo Petromilo | 24.Kreshnik Tepelena |
| 10.Pëllumb Nezha | 25.Grigor Dede |
| 11.Kasëm Mahmuti | 26.Ardian Skëndaj |
| 12.Arben Meksi | 27.Rozina Kormuzi |
| 13.Ervis Moçka | 28.Briseida Çakërri |
| 14.Istref Dobi | 29.Kristaq Meçi |
| 15.Anisa Shametaj | |

Mungojnë:

- 1.Klearda Rapushi
- 2.Alboren Aliaj
- 3.Julian Bleta
- 4.Asime Feraj
- 5.Klara Bajaziti

- 6.Elona Toçaj
- 7.Sulejmën Bubeqi
- 8.Roneda Muçaj
- 9.Andi Resulaj
- 10.Rudi Pashaj
- 11.Ervis Caushaj
- 12.Bujar Osmanaj
- 13.Besian Gega
- 14.Paula Sullaj
- 15.Brunilda Cani
- 16.Anxhela Aliraj
- 17.Teki Xhemalaj
- 18.Gentian Hamzaraj
- 19.Adiola Gjoka
- 20.Mujo Shakaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 7/1, datë 22.06.2023

Znj.Migena Balla – Përshëndetje!

Kuorumi është plotësuar, prandaj fillojmë mbledhjen. Është mbledhja e fundit e këtij këshilli bashkiak. Shkurtimisht do tju përcjell ndjenjat si çdo njeri dhe sidomos të një drejtuesi. Ka qenë e vështirë për këtë këshill bashkiak. Do ta nisja me sfidat , fatkeqësitë natyrore si tërmetet, pandemia si dhe sfidat ndaj vetes. Ato që nuk përbalton dot janë vlerat. Ndihem shumë mirë që kam punuar me ju , kam qenë me ju, si çdo kush, që kemi pas dhe pengesa dhe vështirësi. Nuk jam e kënaqur me vehten si kryetare e këshillit për rrethanat, dhe rrethanat e mia personale , por do të vazhdoj dhe të vazhdojmë të japim kontributin tonë si qytetar.Bukuria qëndron tek njerzit. Kështu të vazhdojmë të jemi, njerëz të mirë, për ta bërë qytetin tonë më të bukur. Duke ju uruar shëndet e mbarësi , fjalën ja kaloj zonjës Jonela, për të na njohur me shprehjen e ligjshmërisë.

Znj.Jonela Halili – Vendimet e këshillit bashkiak nr 39÷41 janë shpallur të ligjshëm nga institucioni i prefektit të qarkut.

Znj. Migena Balla - Vazhdojmë me rendin e ditës.

Z.Ardian Skëndaj - Ka ardhur një projektvendim, për një orar shtesë për linjën Vlorë-Orikum – Vlorë. Është në të mirë të qytetarëve, propozoj të futet në rendin e ditës.

Znj.Migena Balla – Pra, rendi i ditës me 7 pika, përfshirë dhe procesverbalin, kemi dhe dy projektvendime shtesë.

Z.Ardian Skëndaj – Subjektet kanë plotësuar kushtet, por mund të ketë dhe të tjerë, në lidhje me korridoret ujore.

Znj.Migena Balla – Pra, i shtohet rendit të ditës dhe projektvendimi për miratimin e korridoreve ujore....dhe projektvendimi për një shtesë në VKB nr 61

E hedhim në votë rendin e ditës.Votohet.

Pro – 28 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet rendi i ditës.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në “Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë , datë 26.05.2023 .”

E kemi materialin të gjithë në postën elektronike.

E hedhim në votim? Votohet.

Pro – 28 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 7/2, datë 22.06.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin maj 2023”.
Një relacion nga administrata.

Znj.Irena Stasa – Pranë Bashkisë Vlorë, paraqiten familje që dalin nga sistemi i pikëzimit. Janë gjithësej:
- 37 familje që përfitojnë ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë me fondin e planifikuar.
-3 familje të mos trajtohen me ndihmë ekonomike .
-2 familje hyjnë për herë të parë në skemën e ndihmës ekonomike.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?
-Jo.
Kalojmë në votim.
Pro -28 vota
Kundër – 0 vota
Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 7/3, datë 22.06.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin maj 2023”.
Një relacion nga administrata.

Znj.Irena Stasa – Janë 15 familje përfituese nga fondi i kushtëzuar.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? -Jo.
Kalojmë në votim.
Pro – 28 vota
Kundër – 0 vota
Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 7/4, datë 22.06.2023

Znj. Migena Balla – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e listës për fëmijët e familjeve me probleme të thella social ekonomike, që do të frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet me drekë për një periudhë 10 mujore, me të ardhurat e bashkisë “.

Një relacion nga administrata .

Znj.Irena Stasa - Është një fëmijë nga familje me probleme të thella social ekonomike. Ka mbushur moshën , është një fëmijë që shkon në kopsht.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Votohet.

Pro – 28 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 7/5, datë 22.06.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Mbi miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar – prill 2023”.

Z.Daut Zëraj - Duke ju falëndruar për bashkëpunimin, për eksperiencën, për të mirat dhe difektet si dhe për ti përmirësuar ato.....

Analiza e 4-mujorit të parë të vitit 2023, duhet të ishte raportuar më shpejt në kohë, por kishim mosdakortësi me Degën e Thesarit .

-70% , realizimi i të ardhurave.

Realizimi i shpenzimeve, nuk është realizuar sipas planit:

-16,6% nga të ardhurat e veta.

- 43,5% nga granti.

-49,5% nga granti specifik

-70,6% nga buxheti i shtetit...

Zëri “investime”, ka peshën kryesore në mosrealizim , për shpenzimet, për mos ardhjen në kohë të faturave...Njëri nga shkaqet.

I gjithë fondi i trashëguar nga viti i kaluar , u çel për të vazhduar procedurat ...

Të ardhurat , mund të ketë patur ndonjë tolerancë...këto janë disa nga treguesit...

Z.Grigor Dede – E kam parë këtë raport...Problematika ka patur dhe do të ketë. Por, kam një falënderim dhe mirënjohje për të gjithë ju anëtarët e komisioneve, kryetaren, kryetarin e grupit, këshilltarët. Ju uroj gjithë të mirat, suksese të gjithëve në vijim.

Përsa i përket raportit, komisioni i financës, dje nuk u mblodh. Patjetër që duhet punë më e mirë, por le të shpresojmë me organikën dhe kryetarin e ri, të kemi rezultate më të mira.

Z.Sokol Kushta – Falënderoj kryetaren , për shumë peripeci që ka kaluar , ka qenë personi më pozitiv ...

Znj.Migena Balla – E kam marrë prej jush forcën dhe pozitivitetin.

Z.Sokol Kushta – Situatat, kjo eksperiencë negative që kemi kaluar si nga pandemia e shëndetssisë dhe nga pandemia e bashkisë. Falenderoj kolegët për këto vendimmarrje të vështira që kanë marrë këto 4 vjet. Lexova...ata nuk kanë sjellë asnjë gjë, pasi është ndikimi i kryetarit të bashkisë.

-Sa persona keni larguar nga puna dhe sa leje ndërtime , ju si jurist keni kaluar në Apel ?

-Sa është dëmi i 3-4% i buxhetit ?

-Drejtorja e urbanistikës , a keni patur bashkëpunim për lejet e vjetra, bie e ndesh me zhvillimin e sotëm të Vlorës.

Z.Daut Zëraj – Pyetje në formë konstatimi, të zotit Kushta...ky informacion lidhet me drejtorin të tjerë. Pra, kërkoni një evidencë. Pra, nuk mund të merret përgjigje nga askush tani, nuk është as drejtori juridik, as i urbanistikës....Ju po kërkoni analizë.

Z.Ervis Moçka – Për procedurë, neni 53 i ligjit nr 139/2015...derisa të zgjidhet këshilli i ri, këshilli ,merr vendime të kufizuara, vetëm për situata emergjente. Të gjithë projektvendimet, përveç projektvendimeve të ndihmës ekonomike, mendoj se të tjerat do të kthehen nga prefekti si të paligjshëm, duhet një shpjegim.

Pra, duhet një informacion nga administrata , i detajuar...dëmet që sjell, është i riparueshëm apo jo ...

Z.Ardian Skëndaj - Është një projektvendim për koridoret ujore dhe projektvendimi për oraret shtesë , janë emergjentë, ikën koha. Janë të lidhur me sezonin turistik, s'ka kohë të presin.

Znj.Migena Balla - Duhet shtuar një relacion për prefekturën me shkrim.

Z.Ardian Skëndaj – Korridorët janë të domosdoshme. Duhet një relacion.

Z.Daut Zëraj - Është i drejtë mendimi i zotit Moçka. Për procedurë, Lexon...në bazë të ligjit ...,Ky raport është për një periudhë 4-mujore, unë kam raportuar sipas procedurave. Rëndësi ka, që unë kam raportuar në këshill.

Znj.Migena Balla – Ju jeni korrekt sipas ligjit, mos të kalonte muaji i pestë .

Znj.Frosina Qyrdeti – E ka për administratën, zoti Daut .

Znj.Migena Balla – Nëqoftëse, s'ka urgjencë, siç e sqaroi dhe zoti Ervis, ju raportoni, çdo gjë pasqyrohet...Nëqoftëse , ju zoti Daut, nuk keni një argument, kalojmë tek pika tjetër.

E lëmë për këshillin e ri.

(Vjen këshilltari Kastriot Meçi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 7/6, datë 22.06.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerave të subvencionit të qirasë për çdo rast “.

Një relacion të shkurtër nga administrata.

Znj.Drita Mustafai – Ky projektvendim, është i dyti që vjen në këshill për dhënien e subvencionit të qirasë. Janë 5 familje që kanë bërë kërkesë. Bazuar dhe në Urdhërin e Kryetarit të bashkisë Nr 313/2016... Kërkesat e aplikantëve, i kanë kaluar për shqyrtim, gjithë dokumentacioni , Komisionit të Strehimit. Këto 5 familje, përfaqësojnë familje me probleme të ndryshme social ekonomike.

Znj.Migena Balla – Pyetje , diskutime ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 7/7, datë 22.06.2023

Znj.Migena Balla – Vazhdojmë me dy pikat shtesë . Pra, “Mbi një shtesë në VKB Nr 61 datë 27.10.2016”Miratimin e rrjetit të linjave rrethqytetase dhe numrit të orareve për çdo linjë”
Unë kam qenë pjesë e takimit të qytetarëve të Dukatit,Tragjasit, Radhimës, pjesë e kërkesave dhe ankesave të tyre. Kanë nevojë për shtesë të orareve.

Nga administrata?

Znj.Merita Mema – Kjo shtesë orari i takon për vendimmarrje këshillit bashkiak, për ti shtuar si oraret dhe linjat.

Është kërkesë e komunitetit dhe e 2 subjekteve, meqenëse është dhe piku i turizmit, ka fluks, të shtohen dy oraret.

Znj.Liljana Breshani – Të shtohet orari dhe për Zvërnecin. Jam pro linjës së Orikumit, dhe orari mundësisht të jetë deri në 20.00.

Zgjidhja e transportit publik , tregon jetë, zhvillim.

Znj.Merita Mema – Orari i fundit për Orikumin, është ora 19.00

Znj.Edlira Kapllanaj – Jam dakort me shtesën e orarit, sipas propozimit të Liljanës .

Znj.Migena Balla – E hedhim me këto orare për miratim...Duhet folur me subjektet .

Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 7/8, datë 22.06.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 8, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e korridoreve ujore për subjektet Jet Ski”DEJVI” dhe Jet Ski”JULIAN”

Z.Daut Zëraj – Meqenëse, po kaloni këto projektvendime , mendova që do të aklonit vetëm projektvendimet për ndihmën ekonomike.

Znj.Migena Balla – Ju pyeta. A është urgjente ? ta diskutojmë dhe vendosim. A ka urgjenca?
Çdo 4-muaj ..

Z.Ardian Skëndaj – Relacioni që do ti dërgohet prefektit , të jetë i plotë, për këtë projektvendim.

Znj.Migena Balla – Arsyetoje nëqoftëse, është emergjent.

Z.Ardian Skëndaj - Pse janë të domosdoshme këto korridore ujore dhe për shtimin e orareve, relacioni të jetë i plotë, të sqarohen.

Znj.Migena Balla – Administrata një relacion të shkurtër.

Znj.Shaze Kondaj – Projektvendimi, për miratimin e korridoreve ujore, janë 2 subjekte që kanë bërë kërkesë, kanë gjithë dokumentacionin përkatës.

Bazë janë VKM Nr 171/2019 dhe VKM Nr 424/2020, Të dy këto subjekte, bazur në këto më lartë dhe gjithë dokumentacionin plotësues si dhe çertifikatën që kanë marrë nga Ministria e Turizmit, të ushtrojnë aktivitetin në zonën e Jonufrës. Kemi sezonin turistik para.Është i nevojshëm miratimi i këtij projektvendimi , për zhvillimin e sporteve ujore.

Znj.Jonela Halili – Kam një pyetje. Në një shkresë të administratës për Ministrinë e Turizmit, thuhet të miratohet harta e plazheve. Këto elementë janë vendbazimet, kullat e rojeve, korridoret, zona e palzhit...Ky projektvendim merret gjatë sezonit turistik. Përse të mos bëhet i plotë ky përcaktim, për gjithë vijën ujore të Bashkisë Vlorë ?

Znj.Shaze Kondaj – Bazuar në kërkesën e subjektit, duhet çertifikatë si fillim, është kriter , si dhe planvendosja ku do zhvillohet ky aktivitet, marrjen me qira të stacionit të plazhit. S’kanë paraqitur kërkesë.

Znj.Migena Balla – Duhet një hartë e përgjithshme. Mund të vijë më shumë subjekte për aplikim.

Znj.Shaze Kondaj - Bashkia Vlorë , e ka paraqitur hartën dhe e ka nisur në muajin tetor 2022, pranë Ministrisë së Turizmit.

Znj.Frosina Qyrdeti – Ku janë? Ku është harta ?

Znj.Migena Balla – Hartat individuale janë, duhet një e përgjithshme.

Znj.Shaze Kondaj – Për stacionet e plazhit, duhet që subjektet të jenë të licencuar dhe çertifikuar. Ne s’kemi informacion për gjithë operatorët.

Znj.Jonela Halili – Për mosveprim të VKM Nr 171/2019, çfarë përgjigje ka kthyer ministria.

Znj.Shaze Kondaj – Ne , nuk është se, ne nuk jemi dakort me bazën ligjore. Në muajin tetor 2022, ne kemi depozituar një hartë në ministri. Është ai kompetent për miratimin e stacioneve të plazhit.

Znj.Liljana Breshani – Jam pro sporteve ujore, pro zhvillimit. Por, çdo sezon kemi patur probleme me jetën e njerzve , çdo verë. Jam pro këtyre operatorëve që zhvillojnë dhe ushtrojnë këto sporte, por ta marrim tani këtë material....Unë, nuk e kaloj se, duhet të kem siguri.

Znj.Migena Balla – Ky projektvendim është paraqitur në datën 20. Sipas procedurës për çdo muaj vijë projektvendimet, por këtë herë është ndryshe nga ana proceduriale, administrata është brenda afateve. Duhet të jemi të kujdesshëm...konformë rregullave. Nuk e di çfarë mungon.

Z.Kreshnik Tepelena – E kuptoj shumë mirë zonjën Liljana. Duhet t’i bëjmë thirrje administratës, le të kalojnë në filtër korridoret ujore. Ti kalojmë, të jetë fleksibel administrata.

Z.Sokol Kushta – Duhet të vinte si projektvendim më shpejt. Them që, të hiqet një shprehje.....për secilin subjekt.....të gjithë subjektet që plotësojnë kushtet ...Korridoret ujore i ka bashkia. Aksidentet ndodhin ngado. Nuk duhet të minimizojmë turizmin. Hiqni”subjektin”....pra, për të gjitha ato që plotësojnë kushtet.

-A e merr me parcelë? Pra, në të përgjithëshmen , subjekti ka parcelën e vet. Jam kundra një apo dy.. Për çdo subjekt që plotësojnë kërkesat në bashki , këto të miratohen me

Z.Daut Zëraj – Kjo, ose do kalojë kështu..

Z.Ardian Skëndaj - Këta kanë bërë kërkesë dhe plotësojnë kushtet. Ne miratojmë korridoret ujorë.

Znj.Edlira Kapllanaj – Të shtohet në kriteret,të shtohet pika, “ të kontrollohen kriteret..”

Znj.Migena Balla – Ke çertifikatat .

Znj.Edlira Kapllanaj - A janë trajnuar dhe kontrolluar tek mjeku ?

Z.Ervis Moçka – Diskutimet tregojnë se janë sensibil.

Pse është situatë emergjente? VKM dhe ligj , neni apo pika , ku janë bazuar për subjektet ? Nëqoftëse, janë plotësuar të gjitha kushtet, ky projektvendim kalon për miratim. Shtesë nuk mund të bëjmë. Mund të diskutojmë pafund, por jo të bëjmë shtesa.

Znj.Shaze Kondaj - Është emergjent, është sezoni turistik. Është VKM Nr 171/2019, pika 4, që përcakton....(lexon) kriteret, që subjektet duhet të aplikojnë për korridoret ujore.

Kanë marrë liçencën. Kanë të miratuar planvendosjen e vendbazimeve dhe kanë paraqitur shkresë me shkrim. Këto janë kriteret.

Z.Ervis Moçka – Në mungesë të hartës së përgjithshme, kështu do të veprojmë rast pas rasti, ne si këshill ?

Znj.Shaze Kondaj – Po.

Z.Ervis Moçka – Le ti bëhet thirrje subjekteve.

Z.Ardian Skëndaj - Mendoj, ta çojmë në votim, me ato që do të përcaktohen në relacion.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në votim.

Pro – 25 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 4 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 7/9, datë 22.06.2023

Znj.Migena Balla – Zoti Daut këmbëngul.

Z.Daut Zëraj – Analiza 4-mujore, duhet të kishte kaluar. Sot nga këto projektvendime , në kuptimin e emergjencës....

Znj.Migena Balla- Pra, ja ku jemi zoti Daut. Sipas rregullit,që i kalon Ministrisë së Financave, ishim në proces zgjedhor, prandaj u vonua në kohë.

Z.Daut Zëraj – Kemi penalitete nga Ministria e Financës.

Znj.Migena Balla – Vjen në formën e projektvendimit.

Z.Ervis Moçka – Arsyeja, pse është emergjente .

Z.Daut Zëraj – Mund ta them. Ne edhe në muajin maj, mbas zgjedhjeve, ishim në të njëjtën situatë .

Z.Ervis Moçka – Është relativ. Si e thotë ligji .

Z.Daut Zëraj – Nuk mund të justifikohemi, kur projektvendimet e tjera miratohen dhe, ky ngelet. Ka lidhje, me çfarë është bërë.

Z.Ardian Skëndaj – Ta vlerësojë kryetari i ri punën e çdo drejtorie.

Znj.Migena Balla - Jemi tek pika të ndryshme.

Z.Arben Meksi – Duke qenë se, është mbledhja e fundit, duke qenë parlamenti i vogël i Vlorës, ka kujtime sipas meje, kujtime njerëzore dhe kujtime të punës ... Vendimmarrjet, që kemi marrë si këshill në lidhje me punën e bërë për qytetin, urbanizimin, arkitekturën etj. Ky qytet po merr një zhvillim me 3-këndëshin, aeroport – port - bypass, rruga që ndan bllokun e Orizit..., godina e ish-stacionit të trenit, kujtime të punësPërsa i përket kujtimeve të jetës, ka qenë mjaft harmonik. Jam falënderues kryesisë së këshillit bashkia, kryetares, zëvendëskryetarëve, gjithë këshilltarëve. Urime e suksese të gjithëve!

Znj.Migena Balla – Hedhim në votim , miratimin e raportit 4 mujor . Diskutimet u bënë.

Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet raporti i monitorimit .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 7/ 10, datë 22.06.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën të ndryshme.

Z.Kasëm Mahmuti – U bëmë pjesë e këtij këshilli, falë zgjedhjeve të vitit 2019. Patjetër numrat kanë rëndësi.....të bësh opozitë, nuk do të thotë të bërtasësh. Në këto 4 vjet, kemi ofruar alternativat tona, kemi lënë gjurmë.

Falënderoj kryetaren, zëvendëskryetarët, zotin Simo, gjithë këshilltarët dhe administratën .

Znj.Jonela Halili – Fjalë përshëndetëse, për punën, eksperiencën 4-vjeçare (Bashkëlidhur materialit, fjala përshëndetëse e zonjës Halili).

Z.Ardian Skëndaj – Të nderuar qytetarë! Këshilltarë, administrë...

Sot mbyllim një mision fisnik , jo të lehtë 4-vjeçar...(Bashkëlidhur materialit, fjala përshëndetëse e zotit Skëndaj)

Znj.Migena Balla – Duke ju falënderuar, mbyllim këtë mbledhje.